



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 7 paragrafi 1, të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144, nenit 3 të Rregullores së QRK-së 23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2014, miratoi këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NË PROCEDURËN E DHËNIES SË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Ngritët komisioni për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës, në këtë përbërje:

1. Avni Fetahu, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
2. Agron Hyseni, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës
3. Fatlume Jaha, anëtare nga radhët e Kuvendit të Komunës
5. Adelinë Stublla, anëtare nga radhët e Kuvendit të Komunës
4. Bejtush Dushi, anëtar nga Shoqëria Civile

Neni 2

Mandati i Komisionit sipas nenit 1 është i njëjtë me atë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Neni 4

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicë votash të anëtarëve të komisionit.

Neni 5

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren e QRK-së 23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-016-882166
Podujevë,
29 shtator 2014



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi